




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjakovës (KGj), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Ekzekutimi i pagesave nga kategoria jo adekuate në vlerë 273,516€. Prej tyre 244,512€ nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar për paga dhe mëditje si dhe 29,004€ nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar për shpenzime komunale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjakovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi).
- A2 Mos funksionalizimi i web-aplikacionit
- B2 Vonesa në pagesën e faturave.
- B3 Shpenzime shtesë si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 153,098€.
- A3 Vonesa në vlerësimin e tenderëve.
- A4 Mangësi në procedimin e pagesave në vlerë 248,812€.
- A5 Dobësi në përgatitjen e specifikacionit teknik në dosjet e tenderëve.
- B4 Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave.
- B5 Dobësi në menaxhimin e pasurisë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjakovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Gjakovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjakovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit.

Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare, të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit dhe konkluzionin e pajtueshmërisë si: keq klasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi jo i mirë i pagesave, mangësi në proceset e prokurimit dhe dobësi në menaxhimin e pasurisë. Përveç këtyre kemi identifikuar ç'është tjera në menaxhimin financiar dhe të pajtueshmërisë, përfshirë të hyrat, menaxhimin e pasurisë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet kontingjente. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja dhe nëntë (9) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në dy raste kemi identifikuar se ishin ekzekutuar pagesa në kategori ekonomike jo adekuate. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë prej 273,516€. Prej tyre 244,512€ nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar për paga dhe mëditje si dhe 29,004€ nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar për shpenzimet e ujitë për Stadiumin e Qytetit.

Pasi është kryer transaksioni nga Thesari, komuna ka bërë kërkesën në Thesar që pagesa të kryhet (regjistrohet) nga kategoria e pagave. Megjithatë, regjistrimi i shpenzimit për këtë pagesë ka mbetur i njëjtë.

Ndikimi Realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate për mes vendimeve gjyqësore, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që të identifikohen rastet e kërkesave për pagesa përmes vendimeve gjyqësore, më tutje në bashkëpunim me Thesarin të kërkohet që paraprakisht të njoftohet Komuna, dhe që pagesa të bëhet nga kategoria ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Pika 61. Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve paragrafi 20.f. i Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh “Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Nga testimi jonë, ka rezultuar se në tetë (8)⁵ mostra, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi).

Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur për shkak se menaxherët e projekteve nuk kanë ndjekur trajnimet dhe nuk kanë ende njohuri të menaxhimit të kontratës në sistemin elektronik të prokurimit, e-prokurim.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikojnë në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë ndjekjen e trajnimeve për menaxherët e projekteve, për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos funksionalizimi i web-aplikacionit

Gjetja Kontrata Shkallët emergjente dhe dyert e hyrjes së banesave kolektive - kontratë dy vjeçare e nënshkruar me datë 24.12.2021, të kushtet e përgjithshme të kontratës, nën 6 Qasja në vend punishte, paragrafi 6.1 përcakton se Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përdorim me ecurinë e punimeve, do të japë qasje dhe akses Operatorit ekonomik në vend punishte në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto kushte të përgjithshme.

Për projektin “Shkallët emergjente dhe dyert e hyrjes së banesave kolektive” mjetet për projektin janë pranuar, mirëpo dizajni dhe ndërtimi i Web-Aplikacionit që përfshinë dhjetë⁶ module ende nuk janë vënë në funksion.

Shkaku i kësaj ishte, ngase Komuna ende nuk kishte krijuar infrastrukturën bazë për serverë, ku ndërtesa ishte ende e pa rinovuar pa energji elektrike dhe e pa siguruar me kamera.

Ndikimi Mos krijimi i kushteve për funksionalizimin e web-aplikacionit, ka ndikuar në vonesën e finalizimit të projektit, si dhe në mos marrjen e shërbimeve me kohë nga qytetarët.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj që të krijohen kushtet për funksionalizimin e web-aplikacionit, dhe që sa më parë të jetë në shërbim të qytetarëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të Ligjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, kërkohet që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës.

Nga testimi i mostrave, kemi identifikuar vonesa në pagesën e faturave e tejkalojnë kohën e paraparë me ligjin aktual. Në pesë raste faturat në vlerë totale prej 67,738€, pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat janë nga 50 deri 75 ditë kalendarik.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është planifikim jo i mirë i buxhetit dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve pa mjete në dispozicion.

Ndikimi Detyrimet e bartura rrisin rrezikun në mos realizimin e projekteve dhe në mos arritjen objektivave të komunës, si rezultat i nevojës për t'i paguar (obligimet) zotimet e viteve paraprake, njëherit kjo ndikon edhe në kosto shtesë në rast të padive nga furnitorët.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat si dhe që, inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore

Gjetja Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishte 610,390€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 459,082€, ndërsa 151,308€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit, këto janë shpenzuar nga:

- kategoria e Pagave dhe Mëditjeve borxhi kryesor ishte 142,672€ ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit ishin 58,126€;
- kategoria e shpenzime komunale borxhi kryesor ishte 3,078€, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit ishin 775€;

- kategoria e Investimeve Kapitale borxhi kryesor ishte 313,333€, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarrimit ishin 92,407€.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë, ku pjesa më e madhe ishte për shujta dhe transport për implementimin e kontratës kolektive, si dhe pagesave ndaj furnitorëve.

Ndikimi	Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.
Rekomandimi B3	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Vonesa në vlerësimin e tenderëve

Gjetja	Sipas RRUOP, pika 41.2, procedura e vlerësimit të tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Në tenderin "Sanimi i ujërave të zeza dhe atmosferike" Vlerësimi i tenderëve për këtë procedurë tenderimi kishte zgjatur më shumë se 40 ditë nga hapja e tenderëve, dhe për këtë nuk kishte kërkesë nga komisioni për afat shtesë. Sipas zyrtareve përgjegjës të komunës, kjo kishte ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes dhe kontrolleve të pamjaftueshme nga komisioni vlerësues.
Ndikimi	Vonesat në vlerësim të ofertave kanë ndikim negativ në realizim të objektivave dhe planifikimeve operacionale.
Rekomandimi A3	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve të realizohet brenda afatit 30 ditor, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë të zgjatet për një afat shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja	Rregulla financiare Nr.01/2013 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.
---------------	---

Në shtatë (7) raste, faturat në vlerë 248,812€ së bashku me

dokumentacionin mbështetës ishin pranuar nga komuna para datës së kërkesës për zotim të mjeteve.

Shkaku i një dukurie të tillë, ishte si pasojë e mungesës së mjeteve dhe mungesa e komunikimit në mes të zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme paraprakisht, mund ndikoj në mos pagesën në kohë të obligimeve, të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues. Njëkohësisht, mund të ketë padi përmes proceseve përmbarimore, të cilat rrjedhimisht kanë kosto shtesë.

Rekomandimi A4

Kryetari të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Dobësi në përgatitjen e specifikacionit teknik në dosjet e tenderëve

Gjetja

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për prokurimin publik pika 20.8 Specifikimet Teknike, citon se përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar.

Ne kemi vërejtur se, në dy raste Autoriteti Kontraktues në dosjet e tenderit në pjesën e specifikimeve teknike të detyrueshme ishte referuar në një prodhim specifik si:

- Në kontratën Ndërtimi i çerdhes në Dardani në vlerë 208,469€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë referime me prodhime specifike dhe marka tregtare për pozicionet⁸ 9.01 Isomat Aquamat Flex, pozicioni 12.1 Prodhuesi LAMINEX - Austria dhe pozicioni 2.2 Midea Prodhim Midea, GREE-Kinë.
- Në kontratën Ndërtimi i objektit të banimit social në vlerë 279,871€, në formulimin e specifikave teknike ishin bërë referenca me prodhime specifike dhe marka tregtare për pozicionin 1.4 pika 4 Prodhues "Economic" B.

Shkak i kësaj ishte dërgimi i para masës dhe parallogarisë nga njësia kërkuese me prodhime specifike dhe marka tregtare dhe neglizhenca e zyrtarëve të prokurimit për ti ndaluar ato.

Ndikimi

Përgatitja e specifikacionit teknik duke iu referuar një prodhimi specifik dhe marka tregtare, dëmton konkurrencën dhe mund të ndikoj në favorizimin e operatorëve ekonomik të caktuar.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Dobësi në procesin e veprimtarive inspektuese të pronave

Gjetja	Sipas nenit 15.2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna për vitin 2022 nuk ka arrit të kryej inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 38,209 të pronave, gjatë vitit 2022 ka inspektuar vetëm 4557 prej tyre, apo 11%. Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo efikas të veprimtarive inspektuese dhe numrit të pamjaftueshëm të stafit.
Ndikimi	Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.
Rekomandimi B4	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë**

Gjetja	Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e Pasurive jo financiare neni 22 pika 1 citon: Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Kemi evidentuar se komuna nuk i kishte trajtuar çështjet e ngritura në raportin e vitit të kaluar dhe të cilat janë bartur edhe në këtë vit janë: Te pasuria kapitale mbi 1000€ automjete të cilat i takojnë periudhave që nga viti 2001-2007 ende figurojnë në regjistrin e pasurisë me vlerën e tyre fillestare në total prej 34,357€. Ndonëse vlera neto në libra do duhej të ishte zero. Kjo gjendje është rezultat i vendosjes së të dhënave fillestare në SIMFK në mënyrë të gabuar pa iu përcaktuar norma e zhvlerësimit. Komuna kishte bërë komunikime me thesarin për trajtimin e kësaj çështje por megjithatë çështja mbetet ende e pa trajtuar nder vite. Sa i përket çështjes së automjete të cilat i takojnë periudhave që nga viti 2001-2007 dhe që ka rezultuar që gjendja në fjalë të jetë e njëjtë edhe këtë vit, ishte mos kordinimi në mes zyrtareve përgjegjës të Komunës dhe Ministrisë së Financave.
Ndikimi	Mangësitë e identifikuar lidhur me automjetet të cilat i takojnë periudhave që nga viti 2001-2007 dhe ende figurojnë në regjistrin e pasurisë me vlerën e tyre fillestar, ndikojnë që prezantimi i pasurive në pasqyra financiare vjetore të mos jetë e saktë dhe e plotë.
Rekomandimi B5	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i menaxhimit të pasurive, të kryhet në pajtim me Rregulloren për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në 2022 ishin në vlerë 4,697,952€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 840,912€ (gjobat në trafik 777,707€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 63,205€) dhe të hyrat nga kthimi i pagesave të vitit paraprakë 24,055€.

Çështja B6 - Vonesa në shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve

Gjetja	Bazuar në nenin 31 pika 6 të Ligjit nr.06L/005 për Tatimin në pronën e paluajtshme - “Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar”. Nga gjithsej 477 ankesa të shqyrtuara nga komuna, në 23 raste ku tatimpaguesit kanë bërë ankesë lidhur me pasaktësinë e faturës së tatimit në pronë, shqyrtimi i tyre është bërë me vonesë, duke tejkaluar afatin ligjor për shqyrtim nga një deri në tre muaj. Mos funksionimi i mirëfillte i kontroleve të brendshëm, ka ndikuar që shqyrtimi i ankesave të mos jetë brenda afatit ligjorë.
Ndikimi	Mos shqyrtimi i ankesave brenda afatit ligjorë mund të ndikojë në vështirësi në arkëtimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe rritjen e llogarive të arketueshme si pasojë e ankesave të qytetareve.
Rekomandimi B6	Kryetari duhet sigurojë një koordinim me të mirë ndërmjet zyrtarëve përgjegjës, që shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 79,678,993€, pasurive jokatitale është 1,480,125€, si dhe e stoqeve 788,328€.

Çështja A6 - Menaxhimi jo i duhur i automjeteve

Gjetja Sipas Udhëzimit Administrativ MAPL Nr 2008/01 për përdorimin e automjeteve zyrtare në komuna, neni 1 përcakton qëllimin e përdorimit të automjeteve, ndërsa neni 2, përcakton të drejtën e përdorimit të automjeteve, duke plotësuar fletë udhëtimet e përcaktuara nga njësia e transportit. Ndërsa sipas Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12, Kuvendi i komunës mund të miratojë akte brenda fushës së kompetencave të tij.

Komuna nuk mban evidenca për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare (të dhëna ditore për kilometrazhin dhe destinimin për secilën veturë). Për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, nuk ka kërkesa dhe as plotësim të fletë udhëtimeve për udhëtim zyrtar.

Komuna ende nuk e ka miratuar një rregullore për përdorimin e automjeteve zyrtare, si dhe nuk është duke zbatuar UA MAPL nr. 2008/01 për përdorimin e automjeteve zyrtare në komuna.

Shkaku ishte mungesa e kontrollove të brendshëm dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për ti zbatuar rregullat e përcaktuara sipas udhëzimit administrativë.

Ndikimi Dobësitë në menaxhimin e automjeteve zyrtare lidhur me mos plotësimin e të dhënave ditore për kilometrazhin dhe destinimin për secilën veturë, mund të ndikojnë në shfrytëzimin jo racional të tyre, kontroll të dobët dhe menaxhim jo të mirë të shpenzimeve.

Rekomandimi A6 Kryetari, duhet të siguroj që përdorimi i automjeteve dhe mbajtja e evidencave të tyre bëhet sipas kërkesave ligjore, si dhe të inicioj hartimin e një rregulloreje të brendshme për mënyrën e përdorimit të automjeteve zyrtare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2022 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 11,506,693€. Kjo vlerë përbehet tatimi ne pronë 10,581,083€, qirat e dyqaneve 48,320€, qirat e tokave 287,113€, qirat e tregjeve 10€, qirat e parkingjet 22,825€ dhe taksa në firm 567,342€.

Çështja B7 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Bazuar në neni 27 të Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe nenit 16 të Rregullores për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, ku përcaktojnë mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme. dhe neneve 1,3 dhe 4 të Ligjit nr.06/L092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe në nenin 5 të kontratës për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale ku specifikohet se deri me datën 05 të secilit muaj duhet të kryhet pagesa nga ana e shfrytëzuesit të pronës.

Llogaritë e arkëtueshme në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 kishte rritje për 772,540€, veçanërisht të ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë dhe taksa në firmë), ku borxhi ka vlerën prej 4,088,200€. Komuna kishte bërë përpjekje për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara nga tatimi në pronë, qirat nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë, duke dërguar letërkujtesa dhe duke iniciuar rastet në procedura përmbartimore. Megjithatë trendi i rritjes së llogarive të arkëtueshme nga viti i kaluar është edhe me i lartë, rrjedhimisht, kjo situatë përsëritet ndërvite.

Sipas Komunës, kjo ka ndodhur si shkak i pamundësisë së veprimit të komunës në mbledhjen e të arkëtueshmeve ndaj ndërmarrjeve shoqërore.

Ndikimi

Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara ndikon në pamundësinë e komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, dhe po ashtu, mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin dhe vjetërsimin e të arkëtueshmeve deri në shndërrimin e tyre në borxh të keq.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbartuesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2022 ishte 784,425€. Në këtë vlerë përfshihen vetëm vendimet përmbartimore lidhur me kontestet e ndryshme si: Kompensime për profite të humbura, kompensim prone, vërtetim pronësie etj.

Çështja B8 - Llogari jo e plotë e detyrimeve kontingjente në pasqyra financiare

Gjetja Sipas Rregullores MF nr. 01/2017, Neni 3 1.1. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen; dhe Neni 18 Organizatat buxhetore në harmoni LMFP raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Gjatë procesit të auditimit, kemi vërejtur se komuna nuk posedon një regjistër gjithëpërfshirës me vlera të të gjitha pretendimeve të palëve të jashtme ndaj komunës, pasi që në këtë regjistër nuk janë të përfshira proceset gjyqësore të drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë. Zyrtarët përgjegjës nuk kishin arritur ti regjistronin lëndët për vitet paraprake.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos krijimit të një regjistri të përgjithshëm i cili do duhej të azhurnohej dhe mirëmbahej ndër vite lidhur me detyrimet kontingjente nga zyra ligjore në komunë.

Ndikimi Mos posedimi i një regjistri gjithëpërfshirës me vlera të të gjitha pretendimeve të palëve të jashtme ndaj komunës, ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me gjendjen dhe vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente në mënyrë që raportimi i tyre të jetë i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Gjakovës ka të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me të cilin operon vetëm udhëheqësi i njësisë. Gjithashtu, është i themeluar komiteti i auditimit i cili përbëhet nga katër anëtar i cili ka mbajtur katër takime në vitin 2022. NJAB kishte dhënë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm ku kishte përfunduar tre (3) auditime të rregullta aq sa ishin planifikuar me planin vjetor dhe një auditim me kërkesë. Në këto raporte janë dhënë nëntë (9) rekomandime.

Çështja B9 - Dobësi në fushën e auditimit të brendshëm

Gjetja	Rregullorja (QRK) nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik neni 5, pika 1 kërkon që “udhëheqësi i subjektit të sektorit publik themelon Njësine e pavarur të auditimit të brendshëm sipas këtyre kriterëve: 1.1 Subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë milionë euro të ketë së paku tre auditorë të brendshëm”. NJAB kishte vetëm një auditor dhe nuk ka arritur t'i mbulojë të gjitha fushat me rrezik si: menaxhimi i pasurisë, menaxhimin e kontratave të pronave të dhëna në shfrytëzim, llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme, detyrime kontingjente etj. Auditori brendshëm kishte përcaktuar fushëveprimin në mënyrë të përgjithësuar duke mos saktësuar periudhat kohore për të cilat realizohet auditimi. Kjo ka ndodhur për shkak të burimeve të pamjaftueshme në auditimin e brendshëm në komunë.
Ndikimi	Burimet e pamjaftueshme të NJAB ndikon negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit në komunë dhe në arritjen e objektivave të saj.
Rekomandimi B9	Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹⁰	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	26,330,580	29,708,636	26,883,540	27,459,229	27,339,931
Grante Qeveritare - Buxheti	22,952,322	23,010,817	22,346,229	23,695,818	23,077,882
Financimi përmes huamarrjes	0	264,489	264,489	96,003	228,259
Të bartura nga viti i kaluar	0	2,114,405	1,677,526	621,817	1,013,578
Të hyrat vetanake	3,378,258	4,221,001	2,557,216	3,004,022	2,602,543
Donacionet vendore	0	70,580	23,807	30,946	13,995
Donacionet e jashtme	0	27,345	14,272	10,624	403,675

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 3,378,056€. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprak, huamarrja dhe rimëkëmbja. Në vitin 2022 komuna ka shpenzuar 90% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 4% në krahasim me vitin 2021. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	26,330,580	29,708,636	26,883,540	27,459,229	27,339,931
Pagat dhe mëditjet	14,250,978	14,730,243	14,345,541	15,812,416	14,242,133
Mallrat dhe shërbimet	3,240,000	3,945,244	3,858,972	3,258,299	3,687,338
Komunalitë	586,800	620,287	565,968	561,203	532,670
Subvencionet dhe transferet	550,500	723,769	614,000	591,454	682,271
Investimet Kapitale	7,702,302	9,689,092	7,499,060	7,235,857	8,195,520

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar në total ishte rritur për 579,265€. Kjo rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit prej 279,022, vendimit të qeverisë për shtesat në paga pakoja fiskale në shumë 22,600€, garantëve të përcaktuara të donatoreve 13,154€ dhe financimi nga huamarrja 264,489€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 705,244€, kjo rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit prej 324,341€, vendimit të Kuvendit Komunal në shume 230,000, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 144,019€ dhe granteve të përcaktuara të donatoreve 6,884€.
- Buxheti final për shërbimet komunale ishte rritur për 33,487€, ky ndryshim është si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar 41,587, ndërsa me rishikim të buxhetit kishte zvogëlim prej 8,100€.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 173,269€, si rezultat i rishikimit të buxhetit në shumë 50,000€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 120,310€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve 2,959€.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,886,790€, ndryshimi në rritje ishte sipas rishikimit të buxhetit prej 841,088€, të hyrave të batuara nga viti i kaluar në shumë prej 1,808,489€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve për 74,927€, ndërsa me vendim të qeverisë kishte zvogëlim prej 837,714€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Gjakovës në 2022 ishin në vlerë 4,697,952€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet etj. Përveç këtyre të hyrave komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat grumbullohen nga niveli qendror në vlerë prej 840,912€ (gjobat në trafik 777,707€ dhe të hyrat nga gjykata në vlerë prej 63,205€) dhe të hyrat nga kthimi i pagesave të vitit paraprakë 24,055, këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës dhe gjykata.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	3,378,258	3,378,258	4,697,952	4,115,649	2,919,388
Të hyrat tatimore	2,386,068	2,386,068	2,296,134	2,313,597	1,411,815
Të hyrat jo tatimore	992,190	992,190	2,377,763	1,801,140	1,507,572
Të hyrat tjera	0	0	24,055	912	0

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar me 20 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, 11 rekomandime janë zbatuar dhe nëntë (9) rekomandime nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari përmes Menaxherëve të kontratës dhe zyrës së prokurimit duhet të sigurohet që të mos lejoj tejkalime të pagesave për kontratat e përmbushura, sepse ç'do pagese mbi vlerat e kontraktuara me lejimet e aprovuara përbën shkelje ligjore dhe dëmtim i buxhetit.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga Zyra e prokurimit.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet tek menaxherët e kontratave dhe zyrtari certifikues në mënyrë që asnjë pagesë të mos ekzekutohet në mungesë të dëshmive për mallrat apo shërbimet e pranuar krahas specifikave të kontraktuara.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se janë zbatuar procedurat e prokurimit për të gjitha furnizimet dhe shërbimet të cilat janë objekt i prokurimit publik.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, përmes menaxherëve të kontratave, në raportin e pranimit, të përfshihen vetëm punët e realizuara, po ashtu, edhe pagesat të bëhen vetëm për punët e kryera.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që, përmes menaxherit të prokurimit, si dhe menaxherëve të kontratave, se realizimi i kontratave bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat e parapara në kontratë.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se, financimi i OJQ-ve behet vetëm me thirrje publike, në përputhje me kriteret e vendosura si dhe për ç'do përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues, po ashtu, të siguroj që OJQ-të dorëzojnë raporte kthyesë narrative.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
9.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, që gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
11.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kriterëve ligjorë të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme	Nuk ka filluar zbatim

12.	Të hyrat	Kryetari duhet sigurojë se, shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve bëhet brenda afateve ligjore. Po ashtu, Kryetari duhet të shtoj kontrollet për vlerësim të saktë të tatimit në pronë për taksapaguesin.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve, ku ndarja e buxhetit bëhet në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe të dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit duke respektuar kriteret e rregullores për subvencionim të OJQ-ve.	Janë ndërmarrë veprime	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njësive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlllogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga KRPP, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Gjithashtu Kryetari të siguroj se do të realizohet secili pozicion i kontratës me përpikëri.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
15.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë planifikimin e drejtë të buxhetit duke forcuar disiplinën financiare që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar vlerësimi
16.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive të kryhet sipas kërkesës së Rregullores 02/2013, dhe korrigjimi i vlerës neto të pasurive.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
18.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë planifikim të buxhetit adekuat si dhe që, inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të detyrimeve ndaj OE-ve. Gjithashtu, Kryetari duhet siguroj që të kryhen të gjitha detyrimet e viteve paraprake.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim
19.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të sigurojë një sistem të mirëfilltë të kontrollit në mënyrë që të krijohet dhe mirëmbahet regjistri i përgjithshëm i detyrimeve kontingjente në mënyrë që raportimi i tyre të jetë i saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatim

20.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të rishikoj performancën e NJAB dhe sipas nevojës dhe mundësisë financiare dhe buxhetore të ndërmerr veprime për shtimin e kapaciteteve njerëzore brenda NJAB.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme	Nuk ka filluar zbatimi
-----	----------------------	---	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve	• Konfirmoj se përmes emailit, kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”); • Siç kemi diskutuar edhe në takimin tonë të përbashkët të datës 23 Maj, nuk pajtohem me kualifikimin e draft-raportit të Auditorit; • Arsyeja për këtë është sepse vendimet për të cilat është kualifikuar raporti i Komunës së Gjakovës nuk janë marrë nga unë si Kryetar apo kushdo qoftë tjetër në Komunën e Gjakovës, ndërsa në draft raport tek çështja B1 më keni rekomanduar që t’i identifikoj dhe të bashkëpunoj me thesarin, përkundër se ju kemi dëshmuar se nga ana jonë gjithçka ka qenë korrekte dhe në suaza të rregullta ligjore (i keni të gjitha dëshmitë). • Për informim: Pagesa e pagave dhe vendimeve Gjyqësore është kompetencë ekskluzive e Thesarit e jo e Komunave. Arsyetimi i Thesarit - Pagesa e vendimeve gjyqësore është prioritet, nuk kanë të bëjnë me keq klasifikim. Thesari ka realizuar Pagesën e vendimeve Gjyqësore (shujtave e transportin për Profesor) nga Investimet kapitale nga fondi burimor 22 edhe pse ne kemi dërguar 3 emaila zyrtar për përmirësimin e pagesave nga kodit ekonomik 300 kapitalet në kodin ekonomik 111 paga me vlerën e mjeteve të lira në kategorinë pagave nga fondi burimor 10 ku kemi pasur mjete të mjaftueshme që kanë shkua në suficit në vlerë 359,698.19€ ndërsa kërkesa për pagës të vendime gjyqësore ishte 244,512.00€.	Edhe pse pagesa është bërë nga Thesari, PFV nuk prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik për shkak të keq klasifikimit.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese:

- Konfirmoj se përmes emailit, kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Komunës së Gjakovës**, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Siç kemi diskutuar edhe në takimim tonë të përbashkët të datës 23 Maj, **nuk pajtohem** me kualifikimin e draft-raportit të Auditorit;
- Arsyeja për këtë është sepse vendimet për të cilat është kualifikuar raporti i Komunës së Gjakovës nuk janë marrë nga unë si Kryetar apo kushdo qoftë tjetër në Komunën e Gjakovës, ndërsa në draft raport tek **çështja B1** më keni rekomanduar që t'i identifikoj dhe të bashkëpunoj me thesarin, përkundër se ju kemi dëshmuar se nga ana jonë gjithëka ka qenë korrekte dhe në suaza të rregullta ligjore (i keni të gjitha dëshmitë).
- Për informim:** Pagesa e pagave dhe vendimeve Gjyqësore është kompetencë ekskluzive e Thesarit e jo e Komunave. Arsyetimi i Thesarit - Pagesa e vendimeve gjyqësore është prioritet, nuk kanë të bëjnë me keq klasifikim. Thesari ka realizuar Pagesën e vendimeve Gjyqësore (shuajtave e transportin për Profesor) nga Investimet kapitale nga fondi burimor 22 edhe pse ne kemi dërguar 3 emaila zyrtar për përmirësimin e pagesave nga kodit ekonomik 300 kapitale në kodin ekonomik 111 paga me vlerën e mjeteve të lira në kategorinë pagave nga fondi burimor 10 ku kemi pasur mjete të mjaftueshme që kanë shkua në suficit ne vlerë 359,698.19€ ndërsa kërkesa për pagës të vendime gjyqësore ishte 244,512.00€.
- Emailat dhe tabelat e mjeteve të lira nga pagat ju kemi prezantuar auditorëve dhe qëndrojnë në ZKA.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës

Data: 26.05.2023

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹¹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹², duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Piskot - faza e II-të në shumë 174,925€ e nënshkruar me datë 25.08.2021, Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Pika e Zezë - Pjesa II-të, në shumë 152,262€ e nënshkruar me datë 30.09.2021, Ndërtimi i rrugës Tahir Zajmi Carrapatok, në shumë 310,000€ e nënshkruar me datë 14.11.2022, Zgjerimi i rrugës Skënderbeu-Gjakovë, në shumë 271,462€ e nënshkruar me datë 02.09.2021, Aneks-Ndërtimi i qarkores, vazhdimi i rrugës "Bujar Roka", në shumë 353,078€ e nënshkruar me datë 10.11.2022, Sanimi-Ndërtimi i rrugëve me asfalt, në shumë 838,999€ e nënshkruar me datë 17.03.2021, Furnizimi dhe mirëmbajtja me smart city kamerat publike dhe shtyllat multifunksionale dhe paisje tjera faza IV-të në shumë 218,910€ e nënshkruar me datë 16.12.2021, dhe Ndërtimi i objektit të banimit social - Kontratë dy vjetarë, në shumë 279,871€ e nënshkruar me datë 09.08.2022.
- ⁶ Moduli për autentifikim, Moduli për menaxhimin e banorëve, Moduli për menaxhimin e ndërtesave, Moduli për menaxhimin e apartamenteve, Moduli për menaxhimin e pagesave, Moduli për menaxhimin e aktivizimin dhe deaktivizimin e kartelave për qasje, Moduli për menaxhimin e kërkesave dhe ankesave nga ana e banorëve, Moduli për menaxhimin e pyetjeve të përbashkëta për banorët, Moduli për menaxhimin e këshillit të banorëve, Moduli për menaxhimin e pllakave të aksesit nga largësia,
- ⁷
- ⁸ 9.01. Furnizimi me material dhe hidroizolimi i nyjeve sanitare duke përfshirë edhe hidroizolimin e mureve deri në 100 cm lartësi, me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh si Isomat Aquamat Flex në dy shtresa me trashësi nga 1 mm. Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëlhurave të poliesterit ose rrjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasaritjen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me Durocret, Rapicret ose Adiplast. Për më shumë informata rreth mënyrës së aplikimit të materialeve shih përshkrimin teknik dhe broshurat e bashkangjitura; 12.10. POS TP - Panele ndarese per Wc Prodhuesi: LAMINEX - Austria ose I ngjajshem Teresia e paneleve me dyer dhe ndarje. Panelet jane te tipit HPL (High Pressure Laminate) me finish melamine ne te dy anet, rezistente ndaj gervishjeve, grafitëve, thyerjeve, goditjeve, dhe lageshtise. Dizajni sipas skemës së zdrukhtarisë AZ-05; 5.2. Furnizimi transporti dhe montimi I klimave Split-Sistem të tipit inverter me kapacitet 16000 btu/h të përbërë nga njësia e jashtme dhe njësia e brendshme. Në çmim të përfshihen gypat e bakrit për lidhjen e njësive të jashtme dhe të brendshme si dhe gypi për largimin e kondenzatit. Regjimi i punës për ftohje deri në 46°C , për ngrohje deri në -20 °C , tip: MSH-16 HRDN1 . Prodhim Midea, GREE-Kine.
- ⁹ Automjet transporti viti i blerjes 2007; Automjet transporti-fikje zjarri viti i blerjes 2006; Automjet transporti-fikje zjarri viti i blerjes 2006; Automjet transporti-fikje zjarri viti i blerjes 2006; Automjet transporti-fikje zjarri viti i blerjes 2006; Automjet audi viti i blerjes 2003; Automjet transporti viti i blerjes 2006; Automjet transporti viti i blerjes 2006; Automjet transporti viti i blerjes 2006; Automjet transporti viti i blerjes 2006; Automjet transporti viti i blerjes 2006; Automjet transporti viti i blerjes 2006; Automjet-mitsubish viti i blerjes 2001
- ¹⁰ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹¹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹² Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.